



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/17 Nr. i faq./Br.str./No.pg 85

Data/Datum/Date 24 / 03 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 02/7069, të datës 05.03.2026, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2026, merr këtë:

#### V E N D I M

1. **JEPET PËLQIMI** për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (dyzet) vjet të pronës së paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë, përmes procedurës së shprehjes së interesit.
2. Prona e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Zoqisht, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510032-00214-1, në sipërfaqe prej 173m<sup>2</sup> (njëqind e shtatëdhjetë e tre metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3658m<sup>2</sup> (tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike për zhvillimin e aktivitetit biznesor dhe t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. **OBLIGOHET** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.117/26**  
**Më datë:24.03.2026**



**Fatmir Iska**

**Kryesues i Kuvendit**